

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË HEKURUDHA SHQIPTARE SH.A.

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Hekurudha Shqiptare SHA, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë 01.11.2011 deri 31.10.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 52, datë 30.04.2015.

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të ligjit nr. 154/2014, datë 27/11/2014 “Për oraganizimin dhe funksionimi e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresën nr. 1051/11, datë 30.04.2015 dërguar Z. Genci Alizoti, Drejtor i Përgjithshëm i hekurudha Shqiptare Sh.a., Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zbatimit dhe realizimit të rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi i mëparshëm, u konstatua që:

-Nga auditimi u konstatua se Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, nuk ka zbatuar dhe realizuar plotësisht rekomandimet e dërguara nga KLSH-së me shkresën nr. 393/8, datë 13.03.2012. Konkretisht: Nga 20 masa organizative, të rekomanduara janë marrë në konsideratë dhe janë zbatuar plotësisht 7 masa, 5 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 8 masa nuk janë zbatuar.

Nga 3 masa zhdëmtimi të rekomanduara, 2 masa janë zbatuar dhe realizimi i tyre është në proces, ndërsa 1 masë nuk është zbatuar.

Nga 11 masa disiplinore të rekomanduara, janë zbatuar pjesërisht 11, ndërsa nga 8 masa disiplinore të rekomanduar Këshillit Mbikëqyrës, janë zbatuar plotësisht 2 masa, pesë masa janë zbatuar pjesërisht, ndërsa një masë nuk është zbatuar.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë Hekurudha Shqiptare” Sh.a Durrës, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore, trajtuar më hollësisht në faqet 17-19, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

2. Mbi organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese të shoqërisë (Këshillit Mbikëqyrës dhe Drejtorisë).

- Nga auditimi u konstatua se Statuti i Shoqërisë, është miratuar në datë 30.04.2012, në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 230, pika 2, “Shoqëritë tregtare, që kanë ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre, sipas dispozitave të këtij ligji, brenda 3-vjetëve pas hyrjes së tij në fuqi”.

-Këshilli Mbikëqyrës, nuk ka miratuar programin vjetor të auditimit për vitin 2014, si dhe nuk ka ushtruar kontroll për zbatimin e tij për çdo tremujor, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu IV, pika 6.

-Me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 3, datë 14.06.2013, është bërë miratimi i rregullores së organizimit dhe funksionimit të shoqërisë, si dhe i strukturës organizative, në të cilën janë

përcaktuar sektorët, degët, njësitë, numri i punonjësve, por nuk janë përcaktuar kriteret e kërkuara për çdo pozicion pune.

-Niveli arsimor sipas strukturës, nuk është miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, por vetëm nga Administratori. Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar strukturën organizative, vetëm si numër, por nuk ka përcaktuar nivelin e pagave dhe nivelin arsimor për çdo pozicion pune.

-Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e HSH sha Durrës, nuk është përshtatur sipas ndryshimeve të strukturës organizative, ku Njësia e Shërbimeve Mbështetëse, është ndarë nga Njësia Ekonomike, duke bërë dhe ndarjen e detyrave dhe kompetencave respektive. Gjithashtu sipas strukturës së re është shtuar pozicioni “Këshilltari Kordinator”, si dhe pozicioni “Zëdhënës”.

-Në mbledhjen e drejtorisë të datës 16.01.2012, është marrë vendim nr. 1 “Për miratimin e një ndryshimi në projekt-programin e zhvillimit ekonomik të “Hekurudhës Shqiptare” Sh.a për vitin 2012 dhe parashikimin për vitet 2013 dhe 2014”, vendim i cili i është dërguar për miratim Këshillit Mbikëqyrës. Në pikën 2 të këtij vendimi, janë vendosur tarifat e hyrjes në infrastrukturë për përdorim të brendshëm në transportin e udhëtarëve dhe për transportin e mallrave, pa asnjë bazë ligjore ku mbështetet ky vendim, dhe asnjë dokumentacion shoqëruar bashkëngjitur tij. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Statutin e Shoqërisë dhe Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e shoqërisë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” Sh.a Durrës, të zbatojë procedurat ligjore për të përshtatur Statutin e Shoqërisë konform Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 230, pika 2, trajtuar më hollësisht në faqet 19-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

-Këshilli Mbikëqyrës, të miratoj çdo vit programin vjetor të auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe të ushtroj kontroll për zbatimin e tij çdo tremujor, në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, Kreu IV, pika 6, trajtuar më hollësisht në faqet 19-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

-Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa për hartimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të veprimtarisë së Tij, trajtuar më hollësisht në faqet 19-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kriterëve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve, trajtuar më hollësisht në faqet 19-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

3. Mbi hartimin, shqyrtimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar. Ndjekja dhe realizimi i treguesve ekonomiko-financiar në qendër dhe në njësitë e vartësisë.

-Për vitin 2014, programi ekonomiko-financiar (buxheti vjetor), ka pësuar ndryshime gjatë vitit, ndryshime të cilat në disa raste nuk janë miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, si

dhe nuk janë miratuar te Aksioneri i Vetëm “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

-Për vitin 2014, nuk ka patur zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, kjo vërtetohet me faktin në plus minuse në zërat e programit ekonomik, dhe nuk ka patur analiza periodike për të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

-Për vitin 2014, Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, nuk kanë analizuar çdo tremujor gjendjen ekonomiko-financiare të shoqërisë, dhe në vartësi të rezultateve dhe problematikave të konstatuara, të jenë nxjerr vendime dhe rekomandime për zbatim.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të miratojnë programin ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, dhe nëse është parashikuar në statut dhe ligjet specifike, të miratohet edhe nga Aksioneri i vetëm, “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar, trajtuar më hollësisht në faqet 23-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të analizojnë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2014, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre, trajtuar më hollësisht në faqet 23-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2015

4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

-Nga auditimi u konstatua se me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 9, datë 09.10.2013, është emëruar Administratori i Shoqërisë Genci Alizoti, bazuar në propozimin e Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, por nuk është përcaktuar paga e tij, në kundërshtim me udhëzimin e Ministrit të METE-s nr. 318, datë 08.04.2009, kreu IV, pika 2.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Të rishqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës vendimi nr. 9, datë 09.10.2013, për caktimin e pagës së Administratorit të Shoqërisë, në zbatim të udhëzimit të Ministrit të METE-s nr. 318, datë 08.04.2009 dhe të Statutit të Shoqërisë “Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës”, neni 11, trajtuar më hollësisht në faqet 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2015

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kritereve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve, trajtuar më hollësisht në faqet 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të hartohet rregullorja e përcaktimit të kritereve të punësimit, sipas pozicionit të vendeve të punës dhe të merren masa për zbatimin korrekt në rekrutimin apo lëvizjen e punonjësve, trajtuar më hollësisht në faqet 24-26, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

5. *Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore etj, ndaj buxhetit të shtetit.*

-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, i ka hartuar pasqyrat financiare në zbatim të “Udhëzuesit për përpunimin dhe hartimin e pasqyrave financiare”, i miratuar me Vendimin e Administratorit nr. 466 prot, datë 26.06.2012, udhëzues i cili nuk është i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Aksionarit (Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes), si dhe është në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, nuk ka hartuar dhe dërguar në organet tatimore pasqyrat financiare brenda datës 31.07.2014, në kundërshtim me Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, duke rënduar koston me penalitetin në vlerën 10,000 lekë, vendosur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës.

-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a., transaksionet e brendshme që kryejnë njësitë e saj (kryesisht taksa e infrastrukturës dhe shpenzimet e riparimit), nuk i kryen me fatura tatimore të rregullta, por i kryen me anë të **fletë-daljeve të brendshme**, në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe aktet nën ligjore në funksion të tyre.

-Hekurudha Shqiptare Sh.a, nuk e ka paraqitur të plotë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, amortizimin e llogaritur, por një pjesë të tij, e ka paraqitur si pakësim i diferencave të rivlerësimit, të krijuara nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale (AAM), duke paraqitur më pak shpenzime, në pasqyrat financiare në vlerën 608,813,041 lekë për vitin ushtrimor 2011, në vlerën 586,241,657 lekë për vitin ushtrimor 2012 dhe në vlerën 574,247,315 lekë për vitin ushtrimor 2013, në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës, të merren masa për shfuqizimin e vendimit të Administratorit nr. 466 prot, datë 26.06.2012 “Për miratimin e udhëzuesit për përpunimin dhe hartimin e pasqyrave financiare”, vendim i cili është në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, neni 92, trajtuar më hollësisht në faqet 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin e udhëzuesit për përpunimin dhe hartimin e pasqyrave financiare, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, të miratohet në Këshillin Mbikëqyrës dhe nga Aksioneri i vetëm, “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”, trajtuar më hollësisht në faqet 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin, miratimin dhe dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore në organet tatimore, brenda afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa që transaksionet e brendshme të njërive vartëse, të kryhen me fatura të rregullta tatimore dhe këto transaksione të kalojnë nëpërmjet sistemit bankar, në përputhje me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, trajtuar më hollësisht në faqet 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vazhdimisht

-Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të marrin masa për paraqitjen e saktë të shpenzimeve të kryera për subvencion, si dhe kontabilizimi i urdhër-shpenzimeve, të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, trajtuar më hollësisht në faqet 39-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

6. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a ka realizuar 4 investime pa leje zhvillimi, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu III, pika 1/c/i, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10.119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”.

-Studimi i vlerës së kontratës nuk është plotësisht i saktë, pasi në përcaktimin e fondit limit, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, është mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga autoriteti kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu II, pika 2 c dhe ç ku citohet se: “Autoriteti kontraktor, në çdo rast, analizon koston e mallrave, të shërbimeve dhe punëve që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërme dhe specifikimet teknike të mallrave, punëve dhe shërbimeve përkatëse dhe, në çdo rast i dokumenton ato”.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike dhe në këto rregulla, njësia duhet të

argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

-Specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patentë, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “*ose ekuivalent*” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Vendimi për anulimin e procedurës së prokurimit duhet publikuar (botuar) brenda 10 ditëve. Ky konstatim bazohet në numrin e lartë të anulimit të procedurave të zhvilluara, si dhe emrat e njëjtë të fituesve të kontratave të furnizimeve apo të punëve për çdo vit.

-Në dy raste komisionet e vlerësimit të ofertave, nuk kanë në përbërjen e tyre të gjithë specialistët e fushës, për zërat e punimeve që prokurohen, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Kreu V, pika 2, germa, ç, veprim i cili ngarkon me përgjegjësi z. me detyrë administrator i përgjithshëm, në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor.

-Në tetë procedura tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenet 45, 46, 53, 59 dhe 60, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, V, VII DHE IX, të ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

Në dy raste shoqëritë zbatuese, nuk zotërojnë zotësinë profesionale për ta kryer sipërmarrjen e punimeve, pasi licencat e tyre, të regjistruara në regjistrin themeltar të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, nuk zotërojnë kategorinë NS11 “Punime në shina dhe traversa”, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kreu III.

-Në katër raste, dokumentacioni teknik i zbatimit të punimeve të ndërtimit nga sipërmarrësit, nuk është i plotë dhe i saktë, një pjesë e punimeve të zërave të punës, nuk janë kryer sipas specifikimeve teknike, si dhe nuk janë kryer fare (pra janë likuiduar pa u kryer punimi), duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të buxhetit të shtetit në ***vlerën 16,397,268 lekë***.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë të merren masa që investimet për ndërtimet dhe rikonstrukcionet të kryhen me leje zhvillimi, në zbatim të ligjit nr. 10.119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 44-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

-Për një përdorim me efikasitet të fondeve publike të argumentohet domosdoshmëria e kryerjes së prokurimit me leverdinë ekonomike dhe volumet efektive të punëve që do të kryhen;

- Autoriteti Kontraktor, të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.
- Nga Administratori i shoqërisë t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.
- Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njësisë së Prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

Trajtuar më hollësisht në faqet 44-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

7. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

-Hekurudha Shqiptare Sh.a, nuk disponon udhëzim rregullativ të shkruar lidhur me zbatimin e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në lidhje me përcaktimin e strukturave menaxheriale, përcaktimin e nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe linjat e raportimit. Këto rregullime duhet të ishin pasqyruar edhe në rregulloren e brendshme të Shoqërisë, pasi ajo funksionon aktualisht, me rregulloren e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, me vendim nr. 4, datë 18.02.2009, miratuar me shkresën nr. 514/1, datë 19.02.2009 të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike pranë MPPTT.

-Menaxhimi i zërave të shpenzimeve, sanksionohet me Rregullore të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës, por kjo rregullore, duhet të ishte përmirësuar në funksion të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, dhe ndryshimeve ligjore dhe nënligjore në funksion të këtij ligji.

Ka patur mangësi në auditimin dhe vlerësimin në disa fusha si menaxhimi i riskut, vlerësimi i veprimtarisë së TI dhe vlerësimi i performancës në shkallë kompanie, pasi nuk janë kryer auditime të plota për këto departamente. Për vetë specifikat e këtyre fushave këto sisteme, janë audituar dhe vlerësuar nga auditimet e jashtme, kryesisht nga KLSH-ja, apo nga Drejtoria e Auditimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

-Ka mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe pagave, pasi nuk ka rregullore të shkruara për procedurat e rekrutimit në punë, vlerësimin e performancës, trajnimin dhe motivimin e punonjësve.

-Menaxhimi i vlerave materiale, inventarizimit dhe nxjerrjet jashtë përdorimit rregullohet, mbështetur në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve të Njësisë të sektorit publik”.

-Nuk është parashikuar në akte të veçanta, rregullimi i menaxhimit operacional, për urdhrat e kundërshtuar dhe rregullat për delegimin e detyrave, si dy operacione kryesore në menaxhimin financiar.

Të gjithë këto mangësi në procedura dhe rregulla të shkruara, ndikojnë në mos menaxhimin si duhet të vlerave materiale, si dhe në mos funksionimin, si duhet të hallkave të kontrollit të brendshëm.

Rregullimi me akte të miratuara për menaxhimin e sistemeve të veçanta, ndihmon në menaxhimin efektiv, shmang abuzimet, rrit efektivitetin e përdorimit të fondeve, si dhe adreson përgjegjësitë personale për çdo specialist, sipas niveleve të autorizimit.

Njësia Ekonomike, duhet të pozicionohet më qartë si njësi e ngarkuar me ligj, për menaxhimin financiar, si njësi kryesore zbatuese dhe kjo kërkon hartimin e një rregulloreje, ku të përcaktohen funksionet të ndara qartë ndërmjet nëpunësit autorizues, i cili në çdo rast është Administratori i Shoqërisë, nëpunësit zbatues, nëpunësit kontrollues që ekzekutojnë pagesën dhe regjistruarit në kontabilitet.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë dhe Drejtorja e Auditit të Brendshëm, të rishikohet Rregullorja Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm të Shoqërisë, dhe të bëhen rregullimet e nevojshme në lidhje me përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve sipas drejtorive deri në nivel specialisti, trajtuar më hollësisht në faqet 77-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm i Shoqërisë të merren masa, për të hartuar udhëzuesin rregullativ, të shkruar lidhur me zbatimin e ligjit për Menaxhimin Financiar, në lidhje me përcaktimin e strukturave menaxheriale, përcaktimin e nëpunësit autorizues, nëpunësit zbatues dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe linjat e raportimit, trajtuar më hollësisht në faqet 77-80, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të aseteve në ZVRPP përkatëse, përjashtim bën vetëm godina e Drejtorisë së Përgjithshme të “Hekurudhës Shqiptare” Sh.a, dhe ky regjistrim ka qenë i pjesshëm pasi ka përfunduar vetëm për objektin, ndërkohë për truallin është në proces. Në kundërshtim me VKM nr. 120 datë 04.03.2004, pika 2 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit”.

-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, ka lidhur një akt-marrëveshje me përfitime të njëanshme me kompaninë “Kurum International” Sh.a, për shfrytëzimin e trasesë së Hekurudhës për ndërtimin e një peshoreje, për nevoja të kompanisë pa ndonjë detyrim për “Hekurudhën Shqiptare” Sh.a, duke shkaktuar një dëm ekonomik prej **40,392 lekë**, në zbatim të VKM Nr. 529 datë 08.06.2011 “Për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurive shtetërore”.

-Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi rezultoi se: Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, nga mos arkëtim i detyrimeve të kontratave të qirave, i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën **1,506,491 lekë**.

-Nga mos llogaritja dhe faturimi i kamatëvonesave të likuidimit të detyrimeve sipas kushteve të kontratës, buxhetit të Shtetit, i është shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **3,444,259 lekë** në kundërshtim me pikën 6.3 të nenit 6 të Kontratës së Qirasë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a të marrë masat e nevojshme për përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zbatim të VKM nr. 120, datë 04.03.2004, për pronat që janë në proces regjistrimi dhe fillimin e procedurave për pjesën tjetër të pronave, trajtuar më hollësisht në faqet 81-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

-Grupi i punës sipas zonave të kryej monitorimin e kontratave në mënyrë kronologjike dhe raportimin e tyre pranë sektorit përkatës, për arkëtimin në kohë të ardhurave sipas kontratave përkatëse, sipas kapitullit VI pikat 1, 2 3 të VKM nr. 54 datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, trajtuar më hollësisht në faqet 81-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

9. Përdorimi i subvencioneve shtetërore.

“Hekurudha Shqiptare” Sh.a. Durrës, është subvencionuar nga Buxheti i Shtetit për ndihmë shtetërore për transportin e udhëtarëve në vitin 2012 në vlerën 440,000,000 lekë, në vitin 2013 në vlerën 440,000,000 lekë dhe në vitin 2014 në vlerën 440,000,000 lekë (deri më 31.10.2014 është në vlerën 370,000,000 lekë). Pra në total në vlerën 1,320,000,000 lekë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u krye auditim me zgjedhje dhe konkretisht u auditua përdorimi i subvencionit të akorduar nga Ministria e Transporti dhe Infrastrukturës për vitin 2014.

Nga auditimi u konstatua se:

-Jo i gjithë subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit, është përdorur për ndihmë shtetërore për transportin e udhëtarëve, **në kundërshtim me destinacionin e përcaktuar**. Një pjesë e konsiderueshme e këtij fondi, ka kaluar për aktivitete të tjera të kësaj shoqërie dhe kryesisht për paga, sigurime shoqërore, shpenzime karburanti, shpenzime riparimi etj.

-Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financës, nuk kanë përcaktuar strukturën e shpenzimeve që do të mbulohen nga subvencioni. Njëkohësisht Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave, nuk ka të përcaktuar strukturën e shpenzimeve të subvencionit në Këshillin Mbikëqyrës, çka ka krijuar mundësinë që drejtoria e hekurudhës të përcaktojë vetë shpenzimin që mbulohet me subvencion. Konkretisht për paga, sigurime shoqërore, materiale, lëndë djegëse, kosto të biletave, udhëtim dhe dieta, shpenzime telefonike, amortizimi, shpenzime riparimi, taksë e përdorimit të infrastrukturës (taksë e vendosur nga vetë drejtoria, që detyron njësinë e shërbimit të mjeteve lëvizëse, njësinë e biznesit të mallit dhe njësinë e biznesit të udhëtarëve, ti paguajnë njësisë së biznesit dhe menaxhimit të infrastrukturës, taksë për përdorimin e magjistrave kryesore dhe dytësore të rrjetit hekurudhor, pra taksë e brendshme për të rritur shpenzimet me qëllim për të përfituar sa më shumë subvencion).

Shpenzimet e subvencionit kanë kaluar nëpërmjet sistemit të thesarit. Ky subvencion është kryer çdo muaj me urdhër shpenzim të plotësuar dhe nënshkruar nga urdhëruesi (administratori i përgjithshëm i shoqërisë), përgjegjësi i financës dhe nëpunësi i thesarit.

Ky shpenzim ka kaluar për llogari të njësisë së biznesit të udhëtarit, si shpenzim i programuar, si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve dhe jo si diferencë midis çmimit të biletës së udhëtarit të miratuar me VKM nr. 66, datë 07.02.2007 dhe koston për çdo biletë.

Nga 440,000,000 lekë të subvencionuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2014, vlera 269,625, 817.88 lekë nuk është përdorur për subvencion, por është përdorur për shpenzime të tjera, të

drejtorisë së përgjithshme, njësisë së biznesit të mallit, njësisë së infrastrukturës, njësisë mbështetëse etj, si shpenzime page, karburanti, udhëtim e dieta etj.

Për vitin 2013 dhe 2014, nuk është lidhur kontratë ndërmjet Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Hekurudhës Shqiptare. Për vitin 2011, është lidhur kontratë me nr. 3107/1 prot, datë 27.07.2011 dhe nr. 531 prot, datë 11.07.2011, kontratë e cila në nenin 3 të saj ka të përcaktuar “Subvencioni shtetëror i miratuar të përdoret vetëm nga Njësia e Biznesit të Transportit të Udhëtarëve, sipas skemës së miratuar nga vendimet e komisionit të ndihmës shtetërore “Për skemën ekzistuese të subvencionit të hekurudhave”.

Për vitin 2012, është lidhur kontrata me nr. 4557/1 prot, datë 21.11.2012 dhe nr. 863 prot, datë 23.11.2012 (me fuqi para-vepruese, pra datë 01.01.2012), ku në nenin 7 ka të përcaktuar “Subvencioni shtetëror i miratuar të përdoret vetëm nga Njësia e Biznesit të Transportit të Udhëtarëve, sipas skemës së miratuar nga vendimet e komisionit të ndihmës shtetërore “Për skemën ekzistuese të subvencionit të hekurudhave” dhe destinacionit të përcaktuar në Ligjin nr. 10487, datë 05.11.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007.

Për pasojë vlera 269,625,817.88 lekë, përbën shkelje të disiplinës buxhetore, me pasojë dëm ekonomik po në të njëjtën vlerë për buxhetin e shtetit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Përgjithshëm, të merren masa për përcaktuar strukturën e shpenzimeve që do të mbulohen nga subvencioni i akorduar për transportin e udhëtarëve, të miratohet nga organet kompetente, si dhe të lidhet kontrata përkatëse me Ministrinë e Transporti dhe Infrastrukturës, trajtuar më hollësisht në faqet 85-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

10. Hartimi, miratimi i tarifave në transportin e mallrave dhe udhëtarëve, lidhja e kontratave dhe zbatimi i tyre.

Transporti ndërkombëtar bëhet në dy forma:

-Nëpërmjet spedicionereve hekurudhore (Pansped-Serbi dhe 16 February-Mali Zi), me të cilët HSH ka lidhur kontratat përkatëse, ku këta spedicionerë kanë marrë përsipër likuidimin e detyrimeve të transportit për llogari të pritësit të mallit për destinacionin Stacioni Kufitar Bajzë – Stacioni Hekurudhor Pritës.

-Nëpërmjet vetë subjekteve të ndryshme, të cilët paguajnë detyrimet e transportit për relacionin Stacioni Bajzë – stacioni pritës.

Nga auditimi u konstatuan problemet si më poshtë:

-Mos likuidimi në kohë i detyrimeve për kohë qëndrimin e vagonëve të huaj, i cili është bërë një problem shqetësues dhe me pasoja për Hekurudhën Shqiptare. Detyrimi që Hekurudha Shqiptare ka ndaj hekurudhave të tjera “Për orë qëndrimet e vagonëve në territorin e Hekurudhës Shqiptare”, deri më datën 31.10.2014 është në **vlerën 1,370,057 euro**, ose në **vlerën 192,534,110 lekë**, e konvertuar në lekë me kursin e Bankës së Shqipërisë datë 30.04.2015 (1,370,057 euro x 140.53 lekë = 192,534,110).

Në këtë vlerë nuk janë përfshirë penalitetet për mos likuidim në kohë të detyrimeve që Hekurudha Shqiptare ka ndaj hekurudhave të tjera, për përdorimin e vagonëve, penalitete të cilat si rrjedhojë e mos llogaritjes nuk janë kontabilizuar, por është kontabilizuar vetëm principli. Principli është kontabilizuar mbi bazën e urdhrave të çdo muaji nga drejtori i njësisë, çka do të thotë që vlera totale ndaj hekurudha të tjera është më e madhe.

Për sa më sipër;

a. Hekurudhat e huaja kanë filluar të paraqesin dhe detyrimin për kamatë vonesat në likuidimin e detyrimeve.

b. Mjaft hekurudha të huaja, kanë filluar të refuzojnë nisjen e mallrave nga importi me origjinë nga vendet e tyre me vagonët e tyre, si hekurudhat Bullgare apo Polake.

c. Mos likuidimi për një kohe të gjatë, ka ndikuar dhe në performancën e “Hekurudhës Shqiptare” ndaj Hekurudhave të Huaja, problem ky i cili mund të ngrihet dhe në forumet ndërkombëtare hekurudhore.

-Nuk është bërë përkthimi në gjuhën shqipe i marrëveshjes RIV (Rregullore mbi shkëmbimin reciprok të vagonëve), lidhur me dokumentacionin shoqërues të vagonëve për transportin e mallrave dhe aplikimin e kamatëvonesave për orë qëndrimi të vagonëve të huaj, duke ndikuar direkt në rezultatin financiar, pasi kjo krijon vështirësi në përcaktimin e detyrimeve ndërmjet “Hekurudhës Shqiptare” ndaj hekurudhave të huaja, sipas procedurave të parashikuara në RIV.

-Nuk kryhet asnjë veprim financiar dhe kontabël në lidhje me detyrimet financiare që rezultojnë nga kamatëvonesat për orë qëndrimet e vagonëve të huaj, ndaj hekurudhave të huaja. Ky mosveprim nga ana e HSH, nuk krijon besueshmëri për raportimin saktë dhe të besueshëm të detyrimeve dhe rezultateve financiare, për shkak se kamatëvonesat e dërguara nga hekurudhat e huaja pranohen të mirëqena, pa bërë përlllogaritjen e penaliteteve dhe përfshirjen e tyre në raportimet e pasqyrave financiare.

-Nuk janë kryer rakordime ndërmjet HSH, dhe Hekurudhave të huaja, në lidhje me dokumentacionin e hyrje-daljeve të vagonëve të huaj.

-Në dokumentacionin e transportit të mallrave, në përgjithësi mungon lista e vagonëve bashkëngjitur faturës dhe fletë ngarkesës përkatëse, duke krijuar në këtë mënyrë një mos evidentim të saktë të vagonëve të hyrë e të dalë nga territori shqiptar, si dhe orë qëndrimet përkatëse për secilin vagon. Kjo ndikon drejtpërdrejt në përkeqësim të gjendjes ekonomike të HSH, pasi sipas kapitullit 3.3 të RIV, pika 71.1.2, për vagonët e një rëndësie të ulët komerciale aplikohet një tarifë e rritur me 15% nga ora e 241 e qëndrimit për vagonët në territorin shqiptar, e cila rritet me 100% nga ora e 721 e qëndrimit. Ndërsa për vagonët e cilësisë së lartë komerciale aplikohet një tarifë e rritur me 30% nga ora e 241 e qëndrimit për vagonët në territorin shqiptar, e cila rritet me 100% nga ora e 721 e qëndrimit.

-Faturave tatimore të transportit të mallrave, nuk u bashkëngjiten fletëngarkesat e transportit të mallrave. Ky veprim përbën risk në zbatimin korrekt të tarifave, duke i krijuar mundësi aplikuesit dhe përfituesit për shkelje financiare në dëm të Hekurudhës Shqiptare. Ky veprim është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 4, datë 03.02.2014, kapitulli II, pika 1.4.a

-Në shumë raste fletëngarkesat ndërkombëtare (CIM), nuk përputhen me tonazhin e shënuar në faturë.

-Për diferencat e volumeve të mallrave të konstatuara ndërmjet fletëngarkesës ndërkombëtare të transportit të mallrave me hekurudhe (CIM) dhe sasive të faturuara të mallrave, nuk mbahen proces-verbale të konstatimi të këtyre diferencave, si dhe nuk pasqyrohen shkaqet e rezultimit të tyre.

-Në të gjitha rastet e transportit ndërkombëtar të mallrave, Hekurudha Shqiptare, nuk disponon deklaratën doganore, si dhe nuk ka marrëveshje me administratën doganore me

qëllim lehtësimin e kontrollit dhe rregullshmërisë doganore të mallrave, siç është parashikuar në nenin 7 të Ligjit nr. 9167, datë 22.01.2004 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për lehtësimin e kalimeve kufitare për mallrat e transportuara me hekurudhë”.

-Faturave tatimore të lëshuara nga Njësia e Biznesit të Mallit, për efekte parapagimi të mallrave që do të importohen sipas kërkesave verbale të shoqërisë....., nuk i bashkëngjiten dokumentet bankare, që të vërtetojnë arkëtimet e sakta dhe në kohë të parapagimeve. Faturat tatimore të lëshuara për efekt parapagimi hartohen dhe nënshkruhen nga sektori i marketingut bazuar në e-mail që dërgon shoqëria

-Zbritjet në fatura për rastet e parapagimeve apo të uljeve komerciale janë përgjithësisht pa referenca. Edhe në rastet kur ka referenca, kjo e fundit nuk i përgjigjet numrit të faturës së parapaguar.

-Për vitin 2014, nuk janë lidhur kontrata me klientët dhe, veprim në kundërshtim me vendimin nr. 4, datë 03.02.2014 të Këshillit Mbikëqyrës, kapitulli për “Uljet Komerciale”, pikat 1,2,3.

-Në kontratat e lidhura ndërmjet transportuesit HSH dhe klientëve, për transportin e mallrave të ndryshme, nuk janë përcaktuar penaltetet për mosrealizim të kontratës në sasi, si dhe për likuidimet e vonuara të faturave nga klientët.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Drejtoria Ekonomike, të merren masa për hartimin një plani afatgjatë, lidhur me shlyerjen e detyrimeve ndaj hekurudhave të huaja në vlerën **1,370,057 euro**, vënien nën kontroll të shpenzimeve, si dhe uljen e tyre për orë qëndrimet e vagonëve të hekurudhave të huaja, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.12.2015

-Të merren masa nga Administratori i Përgjithshëm dhe Sektori i Marketingut, për kompletimin e dokumentacionit të transportit ndërkombëtar të mallrave, me aktet e rregullores RIV dhe kodet UIC të përkthyer në gjuhën shqipe, në mënyrë që të kryhen veprimet financiare dhe kontabël, dhe tu vihet në dispozicion punonjësve që merren me zbatimin e këtyre kërkesave ligjore, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 31.09.2015

-Nga Administratori i Përgjithshëm, Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Marketingut, të merren masa për të bërë evidentimin dhe regjistrimin e penalteteve të shkaktuara nga mos likuidimi i kamatëvonesave për orë qëndrimet e vagonëve të Hekurudhave të Huaja, konform udhëzimeve të kodeve UIC 304 dhe 311, duke bërë në këtë mënyrë raportim të saktë dhe të besueshëm të detyrimeve financiare, si dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrat financiare, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Të merren masa nga Sektori i Marketingut dhe Dega e Financës të Njesisë së Biznesit të mallit, për të bërë akt-rakordime javore dhe mujore të dokumentuara të hyrje-daljeve të vagonëve të huaj, duke shënuar kështu numrin e vagonit, datën dhe orën e hyrjes së vagonit, llojin e mallit, sasinë e mallit, destinacionin, datën dhe orën e daljes, në mënyrë që të bëhet evidentimi i saktë dhe i plotë i orë qëndrimeve përkatëse për secilin vagon, si dhe faturave tatimore për secilën dërgesë, tu bashkëngjiten fletëngarkesat ndërkombëtare CIM të mallrave, bashkë me fletë-peshimet për secilin vagon, kopje të deklaratës ndërkombëtare doganore

bashkë me urdhër çlirim, listë kalimin e vagonëve, dokumentacion i përcaktuar në modelin D të marrëveshjes RIV, si dhe të mbahen procesverbale për rastet kur evidentohen mungesë në sasi të mallrave apo të korigjimeve të deklaratave ndërkombëtare CIM, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Të merren masa nga dega e financës e Njesisë së Biznesit të Mallit dhe ekonomistët komercial, për shënimin e referencave të faturave të mëparshme për zbritjet e parapagesave, të evidentohet qartë në faturë aplikimi i uljeve komerciale dhe metoda e përlllogaritjes së tyre, si dhe tu bashkëngjitet dokumentacioni vërtetues, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

-Nga Administratori i Përgjithshëm të merren masa për lidhjen e kontratave me të gjithë klientët për transportin kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave, si dhe të parashikohen garanci për mosrealizim të kontratës në sasi, ose për likuidim jo në kohë të detyrimeve për transportin, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

-Nga auditimi për regjistrimin e asetëve pranë Zyrate të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në zbatim të VKM nr. 120 datë 04.03.2004 nga ana e Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” Sh.a ky proces nuk është përfunduar, edhe pse kanë kaluar 10 vjet nga data e miratimit të VKM për kalimin në pronësi të këtyre asetëve.

-Nga auditimi i zbatimit të kontratave të qirave, u konstatuan mos arkëtime të detyrimeve kontraktore të cilat së bashku me penalitetet, janë në vlerën 4,272,682 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

-Nga Administratori i Përgjithshëm dhe Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës, të merren masa e nevojshme për përfundimin e procesit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në zbatim të VKM nr. 120 datë 04.03.2004 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit”, trajtuar më hollësisht në faqet 81-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

Brenda datës 30.09.2016

-Njësia e Biznesit dhe Menaxhimit të Infrastrukturës dhe grupi i punës sipas zonave, të kryejnë monitorimin e kontratave në mënyrë kronologjike dhe raportimin e tyre pranë sektorit përkatës, për eliminimin e vonesave në pagesa dhe mos arkëtimin në kohë i të ardhurave, sipas kapitullit VI pikat 1, 2 3 të VKM nr. 54 datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, trajtuar më hollësisht në faqet 81-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

-Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, nuk janë zbatuar plotësisht procedurat ligjore për përdorimin e subvencionit të akorduar për transportin e udhëtarëve në vitin 2014, duke ndryshuar destinacionin e këtij subvencioni në vlerën **269,625,817.88 lekë**. Konkretisht jo i gjithë subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit, është përdorur për ndihmë shtetërore për transportin e udhëtarëve, në kundërshtim me destinacionin e përcaktuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtij fondi, ka kaluar për aktivitete të tjera të kësaj shoqërie dhe kryesisht për paga, sigurime shoqërore, shpenzime karburanti, shpenzime riparimi etj.

Në fakt ky subvencion përdoret, jo vetëm si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të njësisë së udhëtarit, por është përdorur dhe për mbulimin e shpenzimeve të ndryshme të njësisë të tjera (si drejtoria e përgjithshme e hekurudhës, njësia e biznesit të mallit, njësia e biznesit të infrastrukturës, njësia e biznesit të mjeteve lëvizëse), duke ndryshuar në këtë mënyrë destinacionin e këtij shpenzimi të dhënë nga buxheti i shtetit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqërisë “Hekurudha Shqiptare” Sh.a Durrës, të shqyrtojë përdorimin e subvencionit për vitin 2014 në vlerën **269,625,817.88 lekë**, jashtë destinacionit të përcaktuar, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse në zbatim të Ligjit nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, Vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007, **vlerë e cila për Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik**, trajtuar më hollësisht në faqet 85-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2015

- Nga Shoqëria “Hekurudha Shqiptare”, nuk janë zbatuar plotësisht procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës **198,386 USD**, e konvertuar **në lekë vlera 24,280,462 lekë** (198,386 x 122.39 kursi i dollarit datë 09.02.2015 i Bankës së Shqipërisë) nga kompania “K-Shipping GmbH” Gjermani dhe “Star Speed”, në cilësinë e agjentit të përgjithshëm të kompanisë “K-Shipping GmbH” Gjermani, detyrim i lindur në vitin 2007.

Edhe pse KLSH-ja me shkresën nr. 412/7 prot, datë 25.03.2010, ka rekomanduar “Të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 194,386 USD ngadhe....., në cilësinë e agjentit të përgjithshëm të kompanisë K-Shipping GmbH.

Deri më datën 10.02.2014, nga Hekurudha Shqiptare Sh.a Durrës, nuk është bërë ndryshimi i kërkesë padisë, por vazhdon çështja gjyqësore me kompaninë....., kompani për cilën Konsullata Shqiptare në Gjermani ka dërguar zyrtarisht konfirmimin e saj, duke cituar që kjo kompani në vitin 2001 ka falimentuar, veprim për të shmangur vjeljen e këtij detyrimi ng....., me përfaqësues ligjor i cili ka firmosur faturat dhe fletëngarkesat e transportit të qymyrit koks nga Elbasani me destinacion shtetin Kinë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i **vlerës 24,280,462 lekë**, nga shoqëriadhe....., për shkeljet e konstatuara për transportin i mineralit të hekur-nikelit nga stacioni hekurudhor të Gurit të Kuq-Elbasan me destinacion Kinë, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

-Nga auditimi u konstatua se në tenderin e zhvilluar me objekt Riaktivizimi i stacionit Kashar faza III, viti 2014, u konstatua përfitim i padrejtë nga Shoqëritë..... në vlerën

7,391,400 lekë, për vendosje në objekt të një ndërruese të vjetër (e përdorur), në vlerën= 5,400,000 lekë, në kundërshtim me projektin e zbatimit dhe në specifikimet teknike, si dhe punime të pakryera në katër zëra në vlerën 1,991,400 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **7,391,400 lekë**, ngapër shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Riaktivizimi i stacionit Kashar faza III”, viti 2014, trajtuar më hollësisht në faqet 44-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

-Nga auditimi u konstatua se në tenderin e zhvilluar me objekt, viti 2014, u konstatua përfitim i padrejtë nganë vlerën **822,892 lekë**, për punime të pakryera në dy zëra në vlerën **822,892 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 822,892 lekë**, nga shoqëria....., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt....., viti 2014, trajtuar më hollësisht në faqet 44-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

-Nga auditimi u konstatua se në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbim rinovim agregatesh për lokomotiva hekurudhore”, viti 2014, u konstatua një diferencë në vlerën 430,000 lekë, që përfaqëson pajisje të pa bëra hyrje në magazinë. Konkretisht nuk është bërë hyrje në magazinë një kollok në vlerën 400,000 lekë dhe një indoto dinamo e kombinuar në vlerën 30,000 lekë, nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërëdhe.....

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 430,000 lekë**, nga.....,, dhe për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Shërbim rinovim agregatesh për lokomotiva hekurudhore”, viti 2014, trajtuar më hollësisht në faqet 44-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

-Nga auditimi u konstatua se në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i godinës Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhës”, viti 2014, u konstatua përfitim i padrejtë në vlerën **775,320 lekë** nga shoqëria për punime të pakryera në një zë në vlerën **775,320 lekë**.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 775,320 lekë**, nga shoqëria....., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Rikonstruksioni i godinës Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhës”, viti 2014, trajtuar më hollësisht në faqet 44-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

-Nga auditimi u konstatua se në tenderin e zhvilluar me objekt Riaktivizimi i Stacionit Kashar faza e dytë”, u konstatua përfitimi i padrejtë në vlerën 6,997,656 lekë nga shoqëria....., për punime të pakryera nga në dy zëra. Konkretisht:

-Furnizim ndrruese 1:9R 300 (lidhje provizore), pa vendosje për vlerën 6,158,400 lekë.

-Ndërtim drenazhi mbushje me zhavorr prodhuar me makineri për vlerën 839,256 lekë.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 6,997,656 lekë**, nga shoqëria....., për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Riaktivizimi i Stacionit Kashar faza e dytë”, trajtuar më hollësisht në faqet 44-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

-Në transportin ndërkombëtar të mallrave u konstatua mos aplikim dhe likuidim i drejtë i tarifave të transportit ndërkombëtar hekurudhor të mallrave, në tre raste **në vlerën 60,628 euro, në kundërshtim me** librat tarifor të miratuar nga organet kompetente. Konkretisht nga shoqëria, në vlerën 59,790 euro, shoqëria, në vlerën 499 euro dhe shoqëria, në vlerën 339 euro.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi **në vlerën 60,628 euro**; nga shoqëria në vlerën 59,790 euro, shoqëria në vlerën 499 euro dhe shoqëria në vlerën 339 euro, për mos aplikim dhe likuidim të drejtë të tarifave të transporti ndërkombëtar hekurudhor të mallrave, trajtuar më hollësisht në faqet 90-103, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

-Shoqëria “Hekurudha Shqiptare” Sh.a, ka lidhur një akt-marrëveshje me përfitime të njëanshme me kompaninëpër shfrytëzimin e trasesë së Hekurudhës për ndërtimin e një peshoreje, për nevoja të kompanisë pa ndonjë detyrim për “Hekurudhën Shqiptare” Sh.a, duke shkaktuar një dëm ekonomik prej **40,392 lekë**, në zbatim të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për dhënien me qira ose emfiteozë të pasurive shtetërore”.

-Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi rezultoi se: “Hekurudhës Shqiptare” Sh.a nga mos arkëtim i detyrimeve të kontratave të qirave, i ka shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën **vlerë 1,295,943 lekë**.

-Nga mos llogaritja dhe faturimi i kamatëvonesave të likuidimit të detyrimeve sipas kushteve të kontratës, buxhetit të Shtetit, i është shkaktuar një dëm ekonomik në **vlerën 2,976,739 lekë** në kundërshtim me pikën 6.3 të nenit 6 të Kontratës së Qirasë ku thuhet: **“Qiramarrësi”Detyrohet të paguaj detyrimin mujorë të qirasë brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë. Për çdo ditë vonesë do të paguaj një kamatë ditore prej 1% të vlerës së qirasë mujore.**

Për sa më sipër rekomandojmë:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në vlerën **40,392 lekë** nga kompania për shfrytëzimin e trasesë së Hekurudhës, pa likuiduar qiranë për sipërfaqen 56.1 m² që

shfrytëzon shoqëriatrajtuar më hollësisht në faqet 81-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2015

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi në 14 raste në **vlerën 4,272,682 lekë**, rezultat nga mos-likuidimi i detyrimeve kontraktuale të subjekteve qiramarrëse. Në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksi nr. 1, bashkëlidhur këtij Raporti Përfundimtar Auditimi, trajtuar më hollësisht në faqet 81-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës të nivelit të parë neni 52, kontratave të punës të nivelit të dytë neni 44, si dhe kontratave individuale të punës, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

C/b. "Vërejte me paralajmërim për zgjidhje kontrate"

Ose

"Zgjidhje të kontratës së punësimit", për:

1.me detyrë drejtor ekonomik i Drejtorisë së Përgjithshme;
2.me detyrë shef i sektorit të financës DPH;
- 3....., me detyrë drejtuesi i njësisë së infrastrukturës;
- 4....., me detyrë drejtues i njësisë së shërbimit të mjeteve lëvizëse;
- 5....., me detyrë drejtues i njësisë së mallrave;
- 6....., me detyrë drejtues i njësisë së biznesit të udhëtarit ;
- 7....., me detyrë shef i sektorit të financës të njësisë së infrastrukturës;
- 8....., me detyrë shef i sektorit ekonomik të njësisë së mjeteve;
- 9....., me detyrë shef i sektorit ekonomik të njësisë së mallrave;
- 10....., me detyrë shef i sektorit ekonomik të njësisë së udhëtarit.

Personat e sipërcituar me veprimet dhe mosveprimet e tyre kanë nuk kanë zbatuar procedurat ligjore për përdorimin e subvencionit të akorduar për transportin e udhëtarëve në vitin 2014, duke ndryshuar destinacionin e këtij subvencioni në vlerën **269,625,817.88 lekë**. Konkretisht jo i gjithë subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit, është përdorur për ndihmë shtetërore për transportin e udhëtarëve, në kundërshtim me destinacionin e përcaktuar. Një pjesë e konsiderueshme e këtij fondi, ka kaluar për aktivitete të tjera të kësaj shoqërie dhe kryesisht për paga, sigurime shoqërore, shpenzime karburanti, shpenzime riparimi etj.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9374, datë 21.02.2005 “Për ndihmën shtetërore”, Ligjin nr. 185/2013, datë 02.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit””, Vendimin e Komisionit të Ndhmës Shtetërore nr. 8, datë 02.02.2007 i ndryshuar me Vendimin nr. 15, datë 15.03.2007.

Për personat e përmendur mësipër, Administratori i Përgjithshëm i shoqërisë, sipas shkeljeve ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, por dhe të Performancës së punës së tyre, mund të aplikoj një nga dy masat e rekomanduara.

11....., me detyrë specialiste për sigurinë pranë sektorit teknik të NJBMIH, në cilësinë e kolaudatores të punimeve të ndërtimit në objektin “Riaktivizimi i stacionit Kashar faza III” dhe “Riaktivizimi i stacionit Kashar faza e II”.

Për arsye se në zbatimin e kontratave në tenderat e zhvilluar me objekt:

-“Riaktivizimi i Stacionit Kashar faza III”, viti 2014, u konstatua përfitim i padrejtë nga Shoqëritë “Cara” shpk & shoqëria “Ndregjoni” në vlerën 7,391,400 lekë, për vendosje në objekt të një ndërruese të vjetër (e përdorur) në vlerën= 5,400,000 lekë, në kundërshtim me projektin e zbatimit dhe në specifikimet teknike, si dhe punime të pakryera në katër zëra në vlerën 1,991,400 lekë.

-“Riaktivizimi i stacionit Kashar faza e dytë”, u konstatua përfitim i padrejtë në vlerën 6,997,656 lekë nga shoqëria “Gener 2”, për punime të pakryera në dy zëra. Konkretisht:

-Furnizim ndërruese 1:9R 300 (lidhje provizore), pa vendosje, në vlerën 6,158,400 lekë.

-Ndërtim drenazhi mbushje me zhavorr prodhuar me makineri në vlerën 839,256 lekë.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

12....., me detyrë kryemekanik i oficinës së riparim mjeteve në NJSHML.

13.me detyrë elektrikist lokomotivash në NJSHML.

14....., me detyrë motorist lokomotivash në NJSHML.

15., me detyrë shëf i sektorit të kontrollit teknik pranë NJSHML.

Për arsye se në zbatimin e kontratës të tenderit të zhvilluar me objekt: “Shërbim rinovim agregatesh për lokomotiva hekurudhore”, viti 2014, u konstatua një diferencë në vlerën 430,000 lekë, që përfaqëson pajisje të pa bëra hyrje në magazinë. Konkretisht nuk është bërë hyrje në magazinë një kollodok në vlerën 400,000 lekë dhe një indoto dinamo e kombinuar në vlerën 30,000 lekë.

16....., me detyrë nëndrejtor ekonomik pranë NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

17....., me detyrë kryemekanik i parkut të mjeteve hekurudhore në NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

18....., me detyrë kryemekanik i oficinës së riparimit mjeteve në NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për arsye se në prokurimin elektronik në tenderit me objekt “Kryerje shërbimi për rinovim agregatesh për lokomotiva hekurudhore, viti 2013, kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, si dhe është një akt absolutisht i pavlefshëm, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 46, 53, 55, 59 dhe 60, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, V, VII, të ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120.

19....., me detyrë kryeinxhinier në NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

20....., me detyrë përgjegjës i repartit të shërbimit lokomotivave pranë NJSHML, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

21. me detyrë jurist në sektorin juridik Njësia e Shërbimeve të Brendshme (NJSHMB) në HSH, në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për arsye se në prokurimin elektronik të tenderit me objekt “Kryerje shërbimi për rinovim agregatesh për lokomotiva hekurudhore, viti 2014, kualifikimi, shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, si dhe është një akt absolutisht i pavlefshëm, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenet, 53, 55, 59 dhe 60, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, V, VII, të ndryshuar, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120.

C/c. "Vërejte", për:

22....., nëndrejtor i kapaciteteve në Njësia të Biznesit dhe Menaxhimit Infrastruktural Hekurudhore.

23....., me detyrë shefe e sektorit të pasurive.

24....., me detyrë shefe e sektorit të shfrytëzimit të kapaciteteve për periudhën 23.03.2014 dhe në vazhdim.

25....., me detyrë specialist në sektorin e shfrytëzimit të kapaciteteve në NJBMIH

26....., shërbues në njësia të rajonit Jug Lindje pranë NJBMIH.

27....., specialiste në sektorin e drejtimit të trafikut pranë NJBMIH.

Për arsye se nga mos monitorimi dhe mos arkëtimi i kontratave të qirasë për periudhën objekt auditimi rezultoi se i është shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në *vlerën 4,272,682 lekë*. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 54 datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriteve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

28.**me detyrë magazinier.**

Për arsye se në zbatimin e kontratës në tenderit të zhvilluar me objekt: “Shërbim rinovim agregatesh për lokomotiva hekurudhore”, viti 2014, u konstatua një diferencë në vlerën 430,000 lekë, që përfaqëson pajisje të pa bërë hyrje në magazinë. Konkretisht nuk është bërë hyrje në magazinë një kollokok në vlerën 400,000 lekë dhe një indoto dinamo e kombinuar në vlerën 30,000 lekë.

Shënim:

Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune:.....,,
.....,,
.....dhe....., të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkeljes administrative, për arsye se asnjë prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e shoqërisë, konsiderojmë që për to, të mos propozohet masë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Iliazi, Enida Mata, Alfonc Gabili, Skënder Hajdaraj, Altin Tafilaj dhe Orgest Levani, më tej u shqyrtua nga k/auditues Fatmir Ilizai, Drejtori i Departamentit Xhaferr Xhoxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Sigurimit të Standardeve Ermal Yzeiraj.